

### **III. Editimet themelore në ueb faqe**

Editimet kryesore të tekstit në ueb faqe bëhen në të njëjtën mënyrë si tek programi MS Word .


Përdoret shiriti për formatizim:



#### **1. Krijimi i titujve në tekst**

Në HTML dallohen 6 nivele titujsh: prej *Heading 1* deri *Heading 6*. Më i madhi(më i rëndësishmi është) *Heading 1*

Zgjidhet ashtu që në dokument klikohet në tekst që dëshirohet të paraqitet si titull dhe në listën rënëse për stil(style) nga shiriti për formatizim zgjidhet stili i dëshiruar për titull:



Shembulli për 3 nivele të titujve

## **1. Titulli**

### **1.1. Nëntitulli**

#### **1.1.1. Nëntitullinivelit2**

**Detyrë** : Hapeni ueb sajtin "**tik\_emri\_mbiemri**" (nga ushtrimi paraprak) ku janë krijuar 4 ueb faqe (*index.htm, hyrje.htm, tekst.htm, grafika.htm*).

1. Shkruani titujt në dokumente:

*index.htm* - Sistemet multimediale

*hyrje.htm* - Hyrje në sistemet multimediale

*tekst.htm* - Dixhitalizimi i tekstit

*grafika.htm* - Grafika në kompjuter

të gjithë titujt të jenë *Heading 1*.

2. Në *hyrje.htm* shtoni edhe titullin e nivelit 2 (*Heading 2*) "Çfarë është multimedia" nën tituj "Hyrje në sistemet multimediale"

## Editimi i paragrafit

Si dhe tek Word-i, paragrafi në ueb faqen që e krijojmë me ndihmën e FrontPage është pjesë e tekstit i ndarë me enter. Ndërmjet paragrafëve të tekstit në HTML automatikisht futet distanca (rresht i zbrazët) .


### Kalimi në rresht të ri pa distancë

Vendoset në vendin pas së cilit dëshirohet që teksti të kaloj në rresht të ri dhe zgjidhet **Insert | Break** dhe më pas "*Normal line break*".

### Ndryshimi i nivelizimit (barazimit /rrafshimit) të tekstit

Zgjidhni tekstin të cilin dëshironi ta ndryshoni nivelizimin.

Nga shiriti **Formatting** zgjidhni barazimin majtë, djathtë, qendër ose në të dyja anët (**Align Left, Align**

**Right, Center** ose **Justify**).  të tekstit.

### Dhëmbëzimi i tekstit- Rritja dhe zvogëlimi i hapit (Indent-it)

Zgjidhni tekst(paragraf) dhe për dhëmbëzim të zgjidhet tasti **Increase Indent**, ndërsa për zvogëlim

**Decrease Indent**. 

## Insertimi i një vije horizontale për ndarjen e paragrafëve

Poziciononi kursorin në vend të caktuar të faqes dhe nga menyja **insert** zgjidhni komandën **Horizontal Line**

**Detyrë:**

1. Në *hyrje.html* shtoni në fund të tekstit vijën horizontale.
2. Më pas shkruani nëntitull të ri dhe paragrafët ( mund ta kopjoni këtu tekst ku duhet pasur kujdes që "ta ngjitni" pa formatizim të tekstit të zakonshëm!):  

"Hipertekst

Hipertekst (hypertext) është metodë jo-lineare e organizimit dhe të shfaqjes së informacionit në formë të tekstit i cili përmban lidhje në dokumente të tjerë. Lidhjet janë hiperlidhje (hyperlinks, hot words, hot links).

Karakteristikë e hipertekstit është që lexuesi krijon shtegun e tij vetjak të kërkimit dhe leximit."


Tekst " Lidhjet janë hiperlidhje (hyperlinks, hot words, hot links)." Kaloni në rresht të ri ashtu që mos të ketë distancë( d.m.th të jetë i vendosur *Normal Line Break*).
4. Paragrafët barazoni në të dy anët.
5. Të gjitha titujt të nivelit 1 dhe 2 në faqe centroni
6. Shkruaje titullin e ri "Hipermedia" dhe nën te definicionin hipermedia :  

"Definicioni hipermedia:  
hipermedia = hipertekst + multimedia"
7. Këtë definicion tërhiqe( rrite identin-hapin).

## Editimi i karaktereve


Edhe editimi i karaktereve në ueb faqe përmes FrontPage është njëjtë si dhe në Word dhe për këtë më së shpeshti përdorim veglat d.m.th. tastet në shiritin për formatizim.

### Ndryshimi i fontit( dukja e shkronjave)

Markohet teksti i cili dëshirohet ti ndryshohet fontit dhe nga shiriti i veglave për formatizim zgjidhet menya rënëse e fonteve Font dhe më pas zgjidhet një nga fontet e ofruara . 

### Ndryshimi i madhësisë së shkronjave(fontit)

Markone tekstin të cilin dëshironi ta ndryshoni madhësinë e shkronjave dhe zgjidhni njërin prej dy mënyrave:

1. Mënyra përmes menysë rënëse *Font size* 


2. Mënyra përmes tasteve **Increase Font Size** ose **Decrease Font size**: 

### Vendosja e tekstit në të theksuar, pjerrët dhe i nënvijëzuar


Markohet teksti dhe nga shiriti i veglave zgjidhet **Bold**, *Italic* ose Underline. 

### Ndryshimi i ngjyrës së tekstit

selektohet teksti i cili dëshirohet ti ndërrohet ngjyra dhe zgjidhni butonin në shiritit të veglave **Font Color** i cili hap menynë për zgjidhje të ngjyrës:



me klik zgjidhni ngjyrën e tekstit. Nëse dëshirohet ngjyra e cila nuk është e ofruar, zgjidh opsionin *More Colors*:



### Ndryshimi i ngjyrës së prapavijës (sfondit) së tekstit

selektohet teksti i cili dëshirohet ti ndryshohet ngjyra e prapavijës dhe zgjidhet butoni Highlight në shirit

të veglave :

**Detyrë:** Editoni shkronjat e të gjithë dokumenteve ueb "tik\_emri\_mbiemri".

Zgjidhni si font të tekstit(paragrafit) fontet jo serif font (Arial, Verdana ose Tahoma) të cilët dëshirohet të jenë të madhësisë 10pt.

Titujt më me rëndësi theksoni, pjerrtësoni dhe paraqitni me font tjetër dhe ngjyrë (sipas dëshirës)

Të njëjtën bëjeni edhe me nëntitujt të nivelit 2 dhe 3 duke mbajtur llogari të mbahen sikur të jenë të rëndësisë më të vogël se titulli faqes.

Të gjitha fjalët angleze në tekstet (në *hyrje.html*) pjerrtësoni

Definicionin hipermedia e (në *hyrje.html*) rrite, tërhiqe dhe ndryshoja ngjyrën e prapavijës.

### Krijimi i listave

Në HTML si dhe tek Word-i dallojmë listat e numëruar dhe listat e panumruara (lista me simbole grafik ). Krijohen në të njëjtën mënyrë si në Word dhe më së lehti është përdorimi i butonave nga

shiriti i veglave

**Vërejtje :** Nëse krijoni **listë të re**, së pari klikoni në buton, dhe më pas shkruani elementet e listës. Nëse krijoni listën nga **teksti ekzistues**, selektone tekstin dhe më pas zgjidhni butonin.

**Detyrë:**

1. Në *hyrje.html* bëni listën me numërim nga teksti ekzistues:

1. tekst
2. grafika
3. zëri
4. animacioni
5. video

2. Shtoja dokumentit vijën, dhe më pas titullin e nivelit2 "Kompjuteri multimedial" më pas titullin të nivelit 3 "Pajisjet hyrëse ".

3. Nën titull krijoni listën me shkrimin e tekstit:

- tastiera
- miu ose trackball
- touchscreen
- kartela grafike
- skaneri
- kamera digjitale
- sistemi për njohjen e zërit

4. Në fund të dokumentit editoni tekstin ashtu që i tërë teksti i ri dhe titulli i ri të jenë të harmonizuar me elementet ekzistues përkatës sipas fontit, madhësisë, formës dhe ngjyrës.